

veta. Rrthet orës 19:30, policia e ripërsëriti sulmin dhe, më këtë rast, e plagosën Xhaferin në stomak. Bashkëluftëtarët e kanë bartur me automobil në spitalin e UÇK-së në fshatin e Panorcit/Ponorac [Malishevë/Mališev], por Xhaferi ndërroi jetë në hyrje të fshatit. E kanë varrosur në Panorc/Ponorac, në oborrin e Sahit Velisë. Në datën 4.09.1998, policia serbe hyri në Zatriq/Zatrić. Atje kanë mbetur deri më 11.09.1998. Në ndërkohë, ushtarë të UÇK-së mësuan e Esati dhe Mazllumi nuk ishin me familjet e veta. Pas tërheqjes së policisë serbe nga fshati, ushtarë të UÇK-së e kanë ndërmarr kërkimin e zonës së *Akavanit*. Trupat e masakruar të Esatit dhe Mazllumit i kanë gjetur afro 150 metra larg këtij vendi. Po atë ditë, i varrosën në varrezat e Zatriqit/Zatrić. Në muajin nëntor të vitit 1998, mbetjet mortore të Xhaferit u rivarrosën në varrezat e Zatriqit/Zatrić.

**Burimet:** deklarata B.B, FDH-36753; SHFDUÇK, *Feniksët...12*, 62-64; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092.

### **Shpresa (Ramadan Thaçi) Bytyqi**

(26.12.1966, shqiptare nga Çifllaku/Čiflak, komuna e Rahovecit/Orahovac, amvise, dy fëmijë)

### **Sevdije (Ismajl Morina) Hoti**

(7.12.1968, shqiptare nga Dejna/Danjane, komuna e Rahovecit/Orahovac, amvise, pesë fëmijë)

### **Mukadeze (Fahredin) Bytyqi**

(16.06.1978, shqiptare nga Dejna/Danjane, komuna e Rahovecit/Orahovac, amvise,

### **Leonora (Sadri) Bytyqi**

(4.02.1978, shqiptare nga fshati Dejna/Danjane, komuna e Rahovecit/Orahovac, nxënëse)

### **Arben (Sadri) Bytyqi**

(26.02.1979, shqiptar nga fshati Dejna/Danjane, komuna e Rahovecit/Orahovac, pjesëtar i UÇK-së)

### **Elmaze (Muharrem) Bytyqi**

(24.10.1982, shqiptare nga Dejna/Danjane, komuna e Rahovecit/Orahovac, nxënëse)

### **Bahrije (Gazmend) Bytyqi**

(2.11.1986, shqiptare nga Dejna/Danjane, komuna e Rahovecit/Orahovac, nxënëse)

### **Driton (Fadil) Hoti**

(5.03.1997, shqiptar nga Dejna/Danjane, komuna e Rahovecit/Orahovac)

Gjatë verës së vitit 1998, ushtarët e UÇK-së e kontrollonin fshatin **Dejnë/Danjane**, si dhe fshatrat përreth. Në datën 3.09.1998, forcat serbe e rrethuan fshatin me tanke dhe këmbësori, ndërsa, në hyrje të fshatit, e vendosën një postbllok policor. Pastaj, e sulmuan fshatin me predha. Shumica e banorëve u arratis nga shtëpitë. U strehuan në livadhin e quajtur *Linova*, që gjendet përmbi fshat dhe ndërmjet vreshtave, në *Grykën e Liskovcës/Liskovačka kotilina*. E kaluan natën në atë vend. Ishin ndërmjet 500 dhe 600 persona. Ditën e nesërme, më **4.09.1998**, tre tanke dhe afro 150 ushtarë iu afruan livadhit *Linova*, në distancë prej vetëm 200 metrash. Numri më i madh i burrave ikën me vrap, ndërkaq në livadh mbetën afro 200 gra, fëmijë dhe pleq, të cilët nuk mund të arratiseshin. Pas pak, forcat serbe filluan të gjuanin nga tanket mbi grumbullin e civilëve në *Linovë*. Një predhë e qëlloi për vdekje vëllain dhe motrën, Arbenin dhe Leonoren, që gjendeshin pak më larg, në kodrën përmbi livadh. Arbeni ka qenë pjesëtar i UÇK-së dhe i vetmi person i veshur në uniformë. Predhat, po ashtu, i qëlluan për vdekje Elmazen, Shpresen me vajzën Bahrijen, si dhe Sevdijen me të birin Dritonin. Mukadezen e plagosën rëndë. Një ditë më vonë, familjarët e të vrrarëve i kanë varrosur trupat e viktimave, jo shumë larg vendit ku u vranë. Aty u varros edhe Mukadezja, e cila, në ndërkohë, ndërroi jetë nga plagët e rënda. Arbeni dhe Leonora Bytyqi, gjithashtu, u varrosën afër vendit ku gjetën vdekjen. Në sulmin e forcave serbe atë ditë, ishin plagosur lehtë ose rëndë mbi 50 gra, fëmijë dhe pleq. Disa prej tyre kanë mbetur invalidë të përhershëm. Pas përfundimit të luftës, mbetjet mortore të Arbenit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në fshatin **Dejnë/Danjane**.

**Burimet:** deklarata D.B, FDH-15486; deklarata A.B, FDH-2979; deklarata B.B, FDH-2978; fotografi, FDH-18810; SHFDUÇK, *Feniksët...10*, 29-32; *Serb Troops Launch Full-Scale Attack against Albanian Villages*, pasqyra e lajmeve,